



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 90 datë 22.10.2025

**PËR “MIRATIMIN NË PARIM TË PËRCAKTIMIT TË VENDIT TË PËRKOHSHËM
TË GRUMBULLIMIT DHE ASGJËSIMIT TË KADAVRAVE”**

Bazuar në ligjin Nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Nenin 54 të ligjit Nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 475, datë 30.7.2021, “Për Bashkëpunimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore me Shërbimin Veterinar, në mbështetje dhe të VKM Nr.433/2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”,e ndryshuar si dhe bazuar në shkresën Nr.245/7 prot. datë 02.06.2025 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve,Drejtorisë së Veterinarisë,dhe shkresës Nr.602 prot. datë 16.06.2025 të Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë me qëllim të përcaktimit të grumbullimit,eliminimit dhe asgjësimit apo krematorizimit të kadavrave. Në këtë kuadër Sektori i Emergjencave Civile,Mbrojtjes së Qytetarit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës,Planifikimit të Territorit dhe Sektorit Juridik kanë bërë përcaktimin e vendgroposjes në pasurinë Nr.579 zk.3967 N.B Përmet 1, sipas studimit të bërë nga specialisti veterinar pranë Bashkisë Përmet si dhe bazuar në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e vendit të përkohshëm të grumbullimit dhe asgjësimit të kadavrave në Zonën Kadastrale 3967 N.B Përmet 1, pjesë e pasurisë Nr.579 në pronësi të Bashkisë Përmet sipas VKM Nr.433 dt.08.06.2016.
2. Pozicionimi i vendit të grumbullimit dhe asgjësimit të kadavrave është sipas hartës së marrë nga gjeoportali kombëtar ASIG bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Urbanistikës, Planifikimit të Territorit, Sektorit Juridik e Prokurimeve, Sektori i Emergjencave Civile, Mbrojtjes së Qytetarit dhe Mjedisit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



530318.584
4456590.441

531554.784
4456590.441



530318.584
4456590.441

531554.784
4456590.441

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna
gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike
përgjegjëse.

Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e
autoritetit publik që i ka krijuar ato.

0 50 100 200 m

Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH